# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

## Për Programin e studimit MSc në "Administrim Biznesi"

## ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Shyqyri Llaci

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Tetor/2018

# RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Për Programin e studimit MSc në Administrim Biznesi

| | Tabela e të dhënave për programin e studimit | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti Privat "Albanian University" |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike |
| 3 | Departamenti përgjegjës | Departamenti i Shkencave Ekonomike |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Vendim i KM, Nr.56, datë 21.01.2009 |
| 5 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë | Urdhër i MASH, Nr.327, datë 07.08. 2012 |
| 6 | Titulli i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" VKA Nr. 355, datë 13.07.2012 |
| 7 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 8 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite |
| 9 | Kreditet në total (ECTS): | 120 |
| 10 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 11 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 12 | Programi ofrohet nga institucioni | PO |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | N/A |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | N/A |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | N/A |
| 16 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | Niveli 7 |
| 17 | Aktivizimi i programit të studimit per here te parë | 2010-2011 |
| 18 | Numri i studentëve aktualë | 2016-2017 39 studentë<br>2017-2018 16 studentë |

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi

Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi eshte pjese e programeve te studimit te departamentit te Shkencave Ekonomike, Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, pranë Universitetit Privat "Albanian University". Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike konstatohet se ofron tetë programe studimi të nivelit Bachelor, dy programe studimi të nivelit Master Profesional, gjashtë programe studimi të nivelit Master i Shkencave dhe një program studimi PIND (Program i Integruar i Nivelit të Dytë). Departamenti i Shkencave Ekonomike qe eshte njesia baze pergjegjese per programin e studimit Msc. në "Administrim Biznesi" , ofron dy programe studimi të ciklit të parë Bachelor në Financë-Bankë dhe Bachelor në Menaxhim Biznesi, katër programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznesi, Master Profesional në Menaxhim Bankar dhe Financiar, Master i Shkencave në Administrim Biznesi dhe Master i Shkencave në Menaxhim Bankar si dhe një program studimi të ciklit të tretë Doktoratë në Financë qe nuk eshte aktiv.

Referuar dokumentit te arshivuar në sistemin AMS të ASCAL, GVJ konstaton se Programi Master i Shkencave në Administrim Biznesi, që është subjekt i këtij procesi akreditimi, është hapur me VKM nr. 56, datë 21.01.2009 *[Evidencë ,6 H.3.a.VKM nr.56, dt.21.01.2009.pdf Dosja e vetevleresimit]*, dhe është akredituar për herë të parë me VKA nr.355, datë 13.07.2012 *[Evidencë 7, H.3.b.VKA nr. 355, dt.13.07.2012.pdf, Dosja e vetevleresimit]*, dhe me Urdhër të Ministrit nr. 327, datë 07.08.2012 *[Evidencë 8, H.3.c.UM nr.327, dt.07.08.2012.pdf , Dosja e vetevleresimit]*.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof.Dr. Shyqyri Llaci

Prof.Asoc. Etleva Leskaj

Gjatë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit u asistuan nga specialistët e ASCAL, R. Qatipi dhe E. Xhako.

Më datë 18.10.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018 "*Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*", AU është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 22.10.2018, AU përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft–Raportin, me shkresë Nr. 299/1 Prot., datë 22.10.2018, "*Kthim përgjigje shkresës Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018*". Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

***GVJ pasi u njoh me komentet e percjella nga institucioni ne lidhje me rapportin e GVJ, per PS MSC ne AB, vendosi:***

1. Për komentin e parë në lidhje me literaturën, **nuk kandryshime**. GVJ, vlerëson inciativën e institucionit duke rishikuar syllabuset, ku literatura është e viteve 2013 e në vazhdim, por kjo për syllabuset që do të hyjnë në zbatim, gjatë vitit akdemik 2018-2019. Për periudhën për të cilën akreditohet PS Msc. ne "Administrim Biznesi", gjendja është sikundër është shprehur në raport.
2. Për komentin e dytë **është marrë pjesërisht parasysh** dhe është reflektuar në raport. Ndërsa në lidhje me mospërputhjen në shperndarjen e lendeve me formimin akademik te stafit mbetet sic ka qenë.
3. Për komentin e tretë **nuk ka ndryshime**. GVJ vlerëson vendimmarrjen e institucionit për të përfshirë praktikën në kurrikulën që hyn në zbatim për 2018-2019, siç edhe GVJ e ka shprehur ne

raport, por për vitet për të cilat shtrihet ky vlerësim PS Msc në Administrim Biznesi, nuk ka pasur praktikë.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit per kete program studimi jane:

a) Të shtohet numri i stafit akademik me kohë të plotë, me tituj dhe grada shkencore, të angazhuar në programin MSc në Administrim Biznesi.

b) Të kryhen studime më të argumentuara shkencore mbi nevojat e tregut të punës në të ardhmen e afërt në Shqipëri.

c) Të synohet realizimi i auditimit të jashtëm financiar lidhur me programet master, përfshirë programin MSc në Administrim Biznesi.

d) Të raportohen në mënyrë më të detajuar treguesit e efiçencës së shfrytëzimit të fondeve, veçanërisht të përftuara nga tarifat e studentëve në programin MSc në Administrim Biznesi.

e) Të sigurohet që studentët e këtyre programe studimesh duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

#### a. AU e ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim

Nga analiza që GVJ ka bërë në lidhje me përbërjen sasiore dhe cilësore te stafit konstatohet se nga viti 2012 deri në vitin 2018, stafi efektiv i angazhuar në program ka ardhur duke u rritur, dhe nëse në 2012, 31% e stafit ishin staf akademik efektiv, në 2018 rezulton se 55% e stafit janë staf efektiv. Pavarsisht rritjes se deri tanishme, GVJ sugjeron që AU të intensifikoje përpjekjet për një përfshirje me të madhe të stafit efektiv në këtë program studimi, i cili në asnjë vit te periudhës se akreditimit nuk eshte më e lartë se 55%. Te dhëna me te detajuar qe mbështesin argumentin e mësipërm, jepen në vijim *[Tabelat 3.1-3.6, shtojca bashkëlidhur]*

Në vitin akademik 2017-2018 përbërja e stafit akademik qe mbulon kete program studimi ka qene respektivisht 6 PAE dhe 5 PAK, në 2016-2017 konstatohet se janë 7 PAE dhe 6 PAK. Për vitin 2015-2016 përbërja e stafit akademik që mbulon këtë program studimi ka qenë respektivisht 11 anëtarë, ku 5 janë PAE dhe 6 janë PAK, për vitin akademik 2014-2015 janë 4 anëtarë të stafit akademik, nga të cilët 2 janë PAE dhe 2 janë PAK. Për vitin 2013-2014, janë 9 anëtare të stafit akademik nga te cilët 4 PAE dhe 5 PAK, për 2012-2013 janë 13 anëtarë si stafit akademik, nga te cilët 4 PAE dhe 9 PAK.

Persa i përket përfshirjes se stafit akademik me tituj dhe grada konstatohet se numri i stafit akademik me tituj dhe grada në këtë program studimi si kerkesë imperative e akteve nënligjore, ka ardhur duke u rritur. GVJ referuar tabeles 4.1 dhe 4.2 ne shtojcën bashkëlidhur, konstaton se 100% e stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë vitit 2017-2018 dhe 2016-2017, 2015-2016, janë me tituj akademike ose grade shkencore *[Tabela 4.1, 4.2]*. Për vitin akademik 2014-2015, 50% e stafit akademik të përfshire është me gradë shkencore. gjatë vitit 2013-2014, 22% e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi janë me tituj/grada, për vitin 2012-2013 kjo norme është 54% *[Tabela 4.1]*

#### b. AU e ka përmbushur kryesisht këtë rekomandim

Në lidhje me këtë rekomandim GVJ vlerëson iniciativat e institucionit për të realizuar një studim më të argumentuar shkencor mbi nevojat e tregut të punës për të ardhmen e afërt në Shqipëri. Referuar

informacionit te siguruar nga sistemi AMS, konstatohet se FSHAE, ka ndërmarrë ne vitin 2016 nje studim tregu rreth pozicionit të të diplomuarve ne tregun e punes dhe perceptimit te 70 kompanive te biznesit per nevojat qe keto kompani kane për të diplomuarit *[Evidence 19, R.b.1.1.Studim i tregut per te diplomuarit.pdf]*. Studimi nuk është specifik për këtë program dhe nuk mund të paraqesë nevojat e tregut per te diplomuarit ne kete program. Gjykojmë se me kapacitetet që ka AU mund të realizojë një studim më të detajuar dhe më produktiv.

**c. AU e ka përmbushur këtë rekomandim**

GVJ referuar RVB si dhe opinionit të përgithshëm të ekspertit kontabël të siguruar gjatë vizitës ne institucion, konstaton se AU kryen auditime të jashtme të përvitshme nga auditues të pavarur, raportet e të cilëve paraqesin ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive kryesore të programit master; paga, qera, shpenzime administrative, shpenzime për kërkim-zhvillim si botimet, konferencat, akomodime të lektorëve të huaj, etj. Sipas GVB, këto të dhëna gjenden pranë zyrës së financës, por nuk u konsultuan nga GVJ. GVJ sugjeron që në të ardhmen të ketë një dokumentim me të plotë të auditimit të jashtëm financiar lidhur me programin Msc. në "Administrim Biznesi".

**d. AU e ka përmbushur kryesisht këtë rekomandim**

GVJ referuar informacionit ne RVB, konstaton se në përmbushje te këtij rekomandimi, Fakulteti për programet Master i Shkencave, raporton një shpërndarje të detajuar në përqindje, të shfrytëzimit të fondeve të përftuara nga tarifat e studentëve si më poshtë:

| | |
|---|---|
| A. Të ardhurat 100% | |
| Nga tarifa e studentit | 100% |
| Nga veprimtari shkencore | |
| B. Shpenzime, mësimdhënie dhe shkencë | 80% |
| *1. Fondi i pagave (a+b)* | *60%* |
| a. Për paga-bazë | 22% |
| b. Honorar për orët e mësimit | 38% |
| *2. Fondi i Ekselencës* | *2%* |
| *3. Kosto të tjera të departamentit* | *9%* |
| *4. Personel Administrativ* | *9%* |
| C. Investime | 5% |
| D. Fitimi bruto A-(B+C) | 15% |

Mbështur në rekomandimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm sugjerojmë qe ky raportim te jete me i detajuar dhe specifik per programin Msc në Administrim Biznesi, sepse në formën e mësipërme të raportuar i referohet programeve Master i Shkencave që FSHAE ka.

**e. AU e ka përmbushur këtë rekomandim**

Ky rekomandim eshte përmbushur, mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LAL80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj.

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", pranë Universitetit Privat "Albanian University", implementohet nga departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE). Referuar *Evidences H.2.a.VKA nr.117, dt.18.12.2015.pdf,* FSHAE është krijuar në vitin 2015 nga bashkimi i Fakultetit të Ekonomisë me Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierive me vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë Nr. 117, datë 18.12.2015 dhe Urdhër të Ministrit Nr. 52, datë 05.02.2016 *[Evidencë H.2.b.UM nr.52, dt.05.02.2016.pdf]*. Ky fakultet përbëhet nga tre departamente: 1. Departamenti i Arkitekturës, 2. Departamenti i Inxhinierive dhe 3. Departamenti i Shkencave Ekonomike.

GVJ, referuar RVB si dhe informacionit te siguruar gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, përgjegjës për këtë program studimi, konstaton se misioni i programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", është përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor.

Përsa i përket qëllimit kryesor të këtij programi studimi, ai është transmetimi i njohurive mbi mënyrat e manaxhimit, vendimmarrjen dhe marketingun modern të organizatave dhe institucioneve duke bërë të mundur kultivimin e sensit të udhëheqjes dhe bashkëpunimit.

Objektivat specifikë të PS Msc. ne Administrim Biznesi, ne zberthim te qellimit kryesor dhe te msionit te programit te studimit janë:

1. Mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të kuptuar rolin që sistemi i menaxhimit dhe administrimit ka në një organizatë;
2. Mësimi i aplikimit të koncepteve të fituara të sistemeve bashkëkohore në menaxhim në problemet e biznesit;
3. Fitimi i aftësisë të të punuarit në situata të ndryshme që kërkojnë optimizim nëpërmjet menaxhimit brenda një biznesi;
4. Të kuptuarit e rolit që luajnë menaxheret e niveleve të ndryshme në fushën e biznesit;
5. Të kuptuarit thelbësor të koncepteve menaxheriale dhe mënyrave si mund të aplikohen ato në organizatë;
6. Fitimi i aftësisë për të zhvilluar kritikë të ndryshimeve menaxheriale në proceset e biznesit;
7. Të ofrojë njohuri klasike nga fusha e menaxhimit dhe të rrisë përdorimin praktik të këtyre formave e metodave;
8. Të sqarojë zgjedhjet e metodave tipike të menaxhimit dhe ekonomiksit.

GVJ, konstaton se institucioni, ka hartuar strategjitë në nivel institucional, në nivel njësie kryesore dhe në nivel departamenti *[Evidence 14, R.a.1.Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2013-2017.pdf; Evidence 15 R.a.2.Plani Strategjik i Zhvillimit te Institucionit 2017-2022.pdf; Evidence 16, R.a.3.Plani Strategjik i Fakultetit.pdf; Evidence 17. R.a.4.Plani Strategjik i Departamentit.pdf]*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;<br>**Kriteri 4** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br>**Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;<br>**Kriteri 6** Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | GVJ referuar statutit dhe misionit te deklaruar ne te, si dhe qellimit dhe objektivave te programit të studimit master shkencor në Administrim Biznezi, konstaton se ky program studimi, është hartuar në përputhje me misionin e dhe qëllimin e Universitetit Privat "Albanian University". *[Evidence 26, <u>2.2.Statuti i Universitetit Privat "Albanian University".pdf</u>]*<br><br>GVJ eshte e mendimit se ky program studimi, eshte hartuar ne perputhje me nevojat e tregut te punes. Nga shqyrtimit i dokumentacionit te dosjes se vetevleresimit, konstatohet se Institucioni ka ndermarrë ne vitin 2016 një studim tregu rreth pozicionimit te te diplomuarve ne tregun e punes *[Evidence 19, R.b.1.1.Studim i tregut per te diplomuarit.pdf ]*<br><br>GVJ referuar objektivave te PS Msc. ne "Administrim Biznesi" si dhe kurrikules se tij konstaton se ky PS është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. *[Evidence 39, 3.6, Kurrikula Msc Administrim Biznes.pdf, Arkive]*. Rritja e vazhdueshme e investimeve në vend demostron nevojen ne rritje per te diplomuar me njohuri te thelluara ne fushen e Administrimit te biznesit.<br><br>Referuar takimeve me GVB si dhe me drejtues te institucionit, GVJ konstaton se PS Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" i ofruar nga Albanian University demostron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit dhe në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; | Programi i studimit Msc. në Administrim Biznesi, është hartuar në përputhje me strategjine per zhvillimit të institucionit. GVJ konstaton se nje nder objektivat prioritar strategjik te institucionit eshte mësmidhenia, mësimnxënia dhe kurrikulat me në qendër studentin. *[Evidence 15, R.a.2.Plani Strategjik i Zhvillimit te Institucionit 2017-2022.pdf, Arkive]* |
| **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. | GVJ mbështet mendimin se përmbajtja e programit të studimit MSc. në Administrim Biznesi, pranë Universitetit Privat "Albanian University", është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. *[Dokumenti 22, 23, 24, 25, 26, 27; Dosja e vetevleresimit]*<br><br>Emërtimi i programit të studimit, është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit sipas nivelit 7 të kësaj kornize. Në këtë program studimi, studentët fitojnë njohuri në menaxhimin e biznesit, si dhe aftësitë organizative për të shërbyer |

| | |
|---|---|
| | organizatave publike dhe private |
| **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. | GVJ nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit si dhe nga informacioni i siguruar ne web-in e institucionit, konstaton se institucioni ka hartuar nje plan strategjik ku ndër objektivat kryesore të tij eshte zhvillimi i kurrikulave bashkëkohore si dhe përmiresimi i rezulateteve të mesimdhënies dhe mësimnxënies. *[Evidence 14, 15, Arkive]*<br><br>GVJ, konstaton se institucioni, ka hartuar strategjite jo vetem në nivel institucional, por edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel departamenti. *[Evidence 16, 17, Arkive]*<br><br>Këto dokumenta strategjike fokusohen kryesisht në përmirësimin e cilësisë në fushen e mësimdhënies, kurrikulat dhe mësimnxënia me qëndër formimin e studentëve, kërkimin shkencor dhe inovacionin, sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe veprimtaritë mbështetëse<br><br>GVJ eshte e mendimit se implementimi i suksesshem i planeve strategjike të mësiperm, do t'i sherbejë edhe plotësimit të objektivave të deklaruar të programit të studimit Msc. në "Administrim Biznesi". |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Universiteti Privat "Albanian University", ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.
- Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
- Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, statutin dhe rregulloret e Universitetit Privat "Albanian University"
- Strategjia është zhvilluar në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, dhe ka në fokus zhvillimin dhe përmiresimin e kurrikulave, mësimdhënies dhe mësimnxënies.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur**.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

**Pjesa përshkrimore**

***Terma reference**: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Programi Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", është program që zhvillohet nga departamenti i Shkencave Ekonomike, qe eshte pjese e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Referuar informacionit të siguruar në dosjen e vetëvlerësimit, konstatohet se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga tre njësi baze:

1. **Departamenti i Shkencave Ekonomike** ka në përbërjen e tij 51 pedagogë ndër të cilët 28 janë staf efektiv dhe 23 staf me kontratë.
2. **Departamenti i Arkitekturës**, që përbëhet nga 40 pedagogë ndër të cilët, 21 PAE dhe 19 PAK;
3. **Departamenti i Inxhinierive** përbëhet nga 37 pedagogë ndër të cilët, 23 PAE dhe 14 PAK;

Njësia kryesore ka gjithsej 67 PAE dhe 55 PAK.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Struktura akademike e Fakultetit

Referuar informacionit të siguruar në dosjen e vetëvlerësimit, konstatohet se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga tre njësi baze, Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierive, Departamenti i Shkencave Ekonomike. *[Evidence 28, 2.4.Organograma 2017.pdf, Arkive].* Personeli kademik i njesise kryesore perbehet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU *[Evidencë 26]*. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës, në Rregulloren e Përgjithshme të AU *[Evidencë 27]* dhe në rregulloren e Fakultetit *[Evidencë 25]*. Departamenti i Shkencave Ekonomike eshte organizuar sipas grup lendeve ku identifikohen pesë grup-lëndë: Grup-lëndët e formimit bazë; Grup-lëndët e Manaxhimit; Grup-lëndët e Financë-Kontabilitetit; Grup-lëndët e Ekonomiksit; Grup-lëndët e Statistikë-Matematikë.

GVJ referuar kësaj strukture, mendon se kjo strukturë është në funksion të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni, ka për këtë programi studimi.

☑ Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Referuar te dhënave te siguruara nga institucioni, GVJ konstaton se stafi akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike, përbëhet nga 51 pedagoge, ndër te cilët 55% janë staf efektiv dhe 45% staf me kontrate. Stafi efektiv perbehet nga 28 pedagoge, nder te cilët 57% janë me tituj akademike ose grada shkencore.Stafi me kontratë përbëhet nga 23 pedagogë ndër të cilët 74% janë me tituj akademike ose grada shkencore.*[Evidence, Tabela 2.2]*

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Për këtë fushë, GVJ nuk kërkoi dhe nuk siguroi te dhëna shtesë gjatë vizitës në institucion

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;<br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;<br>**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;<br>**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;<br>**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor". | Referuar organogramës se AU, RVB, vizitës në institucion si dhe dokumentave shtesë të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se organizimi i AU, është në mbështetje të përmbushjes së misionit të tij<br>Sic konstatohet dhe në organogramën e AU, institucioni përbëhet nga tre fakultete, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike me tre njësi bazë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore me tre njësi bazë, si dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore me 4 njësi bazë.*[Evidence 28]*.<br>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, qe është njësia kryesore përgjegjëse për programin Msc. në Admnistrim Biznesi, përbëhet nga 3 njësi baze. FSHAE ka nje plan strategjik në të cilën |

| | |
|---|---|
| | GVJ konstatoi dhe identifikoi 8 objektiva strategjike prioritare.<br><br>Departamenti i shkencave ekonomike si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi konstatohet se përbëhet nga 28 pedagogë efektivë, ndër të cilët 57% janë me tituj akademik ose grade shkencore. |
| **Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe informacionit të siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë si dhe me stafin akademik te programit, vlerëson se këto struktura kanë të qarta përgjegjësitë dhe janë të angazhuara për realizmin e PS Msc. në "Administrim Biznesi".<br><br>Nga shqyrtimi i dosjes se vetëvleresimit si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues te njësise kryesore dhe asaj baze, por edhe nga dokumentacioni i siguruar pranë burimeve njerezore, vlerësojmë si GVJ, se njësia kryesore dhe ajo baze lun rol të rëndësishëm në procesin e rekrutimit.<br><br>Kerkesat per rekrutimin iniciohen nga njesia bazë, i përcillen dekanatit, dekanati përcakton kërkesat në nivel fakulteti dhe i përcjell në rektorat, ku përcaktohen kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. Përgjegjesi i departamentit dhe dekani përkatës janë pjesë të komisionit të seleksionimit të vlerësimit të aplikanteve. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- AU organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.
- Struktura akademike e njësisë bazë përgjegjese per programin Msc. ne Administrim Biznesi, ka të percaktuara përgjëgjesitë dhe është e angazhuar në përmbushjen e tyre

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave , konkludon se **standardet e kësaj fushe konsiderohen të përmbushura.**

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

**Pjesa përshkrimore**

*__Terma reference__: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

Referuar infomacionit të siguruar nga takimet, gjatë vizitës në institucion si dhe RVB, personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor por edhe shërbime dhe detyra administrative, sipas përcaktimeve në Statutin e AU. Personeli akademik i programit të studimit ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Gjatë vizitës në AU dhe informacionit të siguruar pranë zyrës së burimeve njerëzore, GVJ shqyrtoi kontratat e stafit PAE dhe PAK,

në të cilën janë të përcaktuara te drejtat dhe detyrimet e paleve, kohëzgjatja, lëndët që ata do të mbulojnë dhe programin e studimit/lëndët ku përfshihen.

GVJ konsultoi disa praktika te rekrutimit te stafit akademik efektiv dhe me kontrate dhe konstatoi se përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik bëhet nëpërmjet konkursit. Departamenti pas një analize të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në dekanat, i cili i përcjell kërkesat në nivel njësie kryesore rektoratit, i cili përcakton kriteret dhe procedurat e konkurimit. Kriteret e rekrutimit janë të deklaruara, dhe ashtu sikundër paraqitet edhe në RVB, ato janë:

- Përfundimi i ciklit të dytë të studimeve në profilin përkatës sipas lëndës që do të mbulojnë me mesatare mbi 8 (tetë);
- Të kenë së paku gradën shkencore "Doktor" ose PhD;
- Eksperienca në mësimdhënie dhe eksperiencë profesionale, e lidhur me lëndën që do të mbulojnë;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 3, 4, 5 në Aneks)

Të dhënat për personelin akademik dhe me kontratë paraqiten në Tabelat 3.1.-3.6 , shtojca bashkëlidhur. Referuar këtyre Tabelave, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit "Master i shkencave" në "Administrim Biznesi" është si më poshtë

- për vitin 2017-2018 përbëhet nga 11 pedagogë, nga të cilët 6 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 5 janë staf akademik me kontratë (PAK).
- për vitin 2016-2017, nga 13 pedagogë të përfshirë në mësimdhënie, 7 janë PAE, dhe 6 janë PAK.
- për vitin 2015-2016 përbërja e stafit akademik qe mbulon kete program studimi ka qenë respektivisht 11 anëtarë, ku 5 janë PAE dhe 6 janë PAK,
- për 2014-2015 janë 4 anëtarë të stafit akademik, nga të cilët 2 janë PAE dhe 2 janë PAK.
- për vitin 2013-2014, janë 9 anetarë të stafit akademik nga të cilët 4 PAE dhe 5 PAK,
- për 2012-2013 janë 13 anëtarë si stafit akademik, nga të cilët 4 PAE dhe 9 PAK.

Referuar këtij informacioni, 55% e stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë 2017-2018, përbëhet nga stafi akademik efektiv, ndërsa gjatë 2016-2017, kjo normë është 54%, per 2015-2016 janë PAE 46 %, për 2014-2015 janë PAE 50%, per 2013-2014 janë PAE 45 %, per 2012-2013, është PAE 31% e stafit te perfshire ne kete program studimesh.

Nga sa me sipër, GVJ konstaton se stafi akademik efektiv gjatë periudhës për të cilën institucioni akreditohet, është në intervalin 31%-55% e stafit akademik të përfshirë në program.

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 4 në Aneks)

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelën 4.1 4.3, shtojca bashkëlidhur. 100% e Stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë vitit 2017-2018 dhe 2016-2017, 2015-2016, janë me tituj akademike ose grade shkencore *[Tabela 4.1, 4.2]*.

Për vitin akademik 2014-2015, 50% e stafit akademik te perfshire eshte pa gradë shkencore. *[Tabela 4.2]* Gjate vitit 2013-2014, 78% e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi janë pa tituj/grada, per vitin 2012-2013 kjo norme është 46% *[Tabela 4.1]*

Nga sa më sipër GVJ gjykon se per tre vitet e fundit te periudhës per te cilën programi akreditohet ka nje përmirësim cilësor te ndjeshëm, te përfshirjes se stafit akademik me tituj dhe grada.

Pavarësisht kësaj, në tre vitet e para te periudhës per te cilën akreditohet GVJ konstaton se norma e stafit akademik pa tituj/grada ka qene ne intervalin 50%-78%, e cila vleresohet relativisht e lartë.

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat 5 në Aneks)

Të dhëna për përbërjen moshore të stafit akademik, të përfshirë në këtë program studimi, paraqiten në Tabelat 5.1-5.6 në shtojcë. Referuar këtyre tabelave 100% e stafit akademik efektiv dhe me kontratë per te gjithë periudhën e akreditimit janë nën moshën 65 vjec. Gjithashtu vihet re nje shpërndarje normale e harmonizuar e stafit ne intervalet moshore 25-35, 36-45, 46-55, 55-65 vjec.

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Referuar dosjes se vetëvlerësimit si dhe dokumentacionit te siguruar gjate vizitës ne institucion dhe informacionit pranë burimeve njerezore, GVJ konstaton se kontratat e punës, përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet, kohëzgjatjen, pushimet, mënyrat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve, lëndet që stafi do të mbulojë si dhe programin ku do të përfshihet. *[Evidence 31, 3.1.a Kontratë pune PAE.pdf]*

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita e bere ne institucion dhe takimet me safin administrativ, GVJ konstaton dhe vlereson se stafi administrativ ka te qarta pergjegjesite dhe angazhohet ne permbushjen e ketyre pergjegjesiv.e

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion, u siguruan informacione per, praktikat e rekrutimit, kontratat e punës, ngarkesën mesimore te stafit te programit, listën e pedagogëve të perfshire në programin e studimit qe akreditohet.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | GVJ, bazuar mbi RVB, takimet me stafin akademik të programit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion vëren se, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programit të studimit Msc në "Administrim Biznesi" dhe për plotësimin e tyre.<br><br>Stafi akademik angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Përvec procesit mësimdhënies ata janë të angazhuar në përfshirjen në projekte, në konferenca shkencore dhe në botime.<br><br>Gjithashtu konstatohet një angazhim optimal i stafit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, në mbështetje të implementimit të strategjise për zhvillim të institucionit dhe te objektivave te PS Msc. ne "Administrim Biznesi". |

| Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. | GVJ konstaton nga takimet me stafin akademik te programit si dhe me drejtues te njesise baze dhe kryesore, se personeli akademik ka lirinë e nevojshme akademike për zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulës së programit. GVJ siguroi gjatë vizitës në institucion praktikën e plotë për ndryshimin e kurrikules, vendimmarrja për të cilën iniciohet në diskutimet në mbledhjet e departamentit.*[Evidence 1. Propozimi nga Njesia Baze tek Dekani.pdf, Vizita ne institucion]*.<br><br>Departamenti ngre një grup ekpsertesh për rishikimin e kurrikulave qe propozon ndryshimet përkatëse te Dekani. *[Evidence 3. Kurrikulat e propozuara 2018-2019.pdf, Vizita ne institucion]*.<br><br>Dekani mbi vlerësimin teknik të Zyres së Zhvillimit të Kurrikulave e përcjell propozimin të Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. *[Evidence 5. Vleresim teknik nga Zyra e Zhv.Kurrikulave.pdf, Vizita ne institucion]*.<br><br>Komisioni pasi e shqyrton propozimin e përcjell në Senatin Akademik i cili merr vendimin përfundimtar. *[Evidence 8. Vendim Senati Akademik.pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>Referuar RVB si dhe informacionit te siguruar nga drejtuesi i njesise baze, pergjegjes per kete program studimi, konstatohet se përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në bazë të Udhëzimit nr.20 dhe Udhëzimit nr.40. Nga informacioni i siguruar gjate vizites ne institucion, nga praktikat e rekrutimit te konsultuara, GVJ identifikoi raste te rekrutimeve te stafit akademik efektiv pa graden shkencore, te cilet ne ngarkesen e tyre mesimore ne kete program studimi jane te perfshire në dhenien e leksioneve *[Evidence 14, Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]* |

| Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. | GVJ konstaton se njoftimet per rekrutimet behen prane akp ose mediat visive ose te shkruara *[Evidence, 24.1 Printscreen shpallja e vendeve vakante.pdf, vizita ne institucion]*<br><br>Referuar RVB, nder kriteret kryesore te rekrutimit te stafit akademik jane përfundimi i ciklit të dytë të studimeve në profilin përkatës sipas lëndës që do të mbulojnë me mesatare mbi 8 (tetë) dhe kandidatet të kenë së paku gradën shkencore "Doktor" ose PhD etj. GVJ gjate konsultimit te praktikave te rekrutimit gjate vizites ne institucion, konstatoi rekrutime dhe te aplikanteve te cilet nuk kane graden shkencore, nderkohe qe referuar RVB, pasja e grades shkencore eshte kusht.<br><br>Gjithashtu gjate konsultimit te praktikave te rekrutimit, u identifikuan raste te mungeses se lejes se punëdhënësit kryesor per angazhimin e tyre ne mesimdhenie ne institucione te tjera |

| | |
|---|---|
| | Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në PS Msc ne Administrim Biznesi, përbën 65 % të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit. Duke qene se personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në PS Msc ne Administrim Biznesi, eshte nen normen minimale 70%, institucioni duhet te garantoje nje rritje te angazhimit te stafit akademik efektiv ne kete PS.<br><br>GVJ nga dokumentacioni i siguruar gjate vizites ne institucion vlereson se AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit, te cilat perfshijne disa forma vleresimi, si vetëvlerësimi, vlerësimi nga drejtuesi I njesise baze, vleresim nga studentet. *[Evidence, 29.1 Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE MSc.pdf, Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE, Vizita ne institucion]*<br><br>GVJ prane zyres se burimeve njerezore, konstatoi se ka një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, te komisioneve te nrgritura, te vendimeve te marra prej tyre etj. |
| **Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.** | |
| **Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;<br><br>**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;<br><br>**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. | Përgjegjësi i programit te studimit Msc në Administrim Biznesi, mban titullin "Prof.Asoc".<br><br>Referuar shperndarjes se lendeve te programit Msc ne Administrim Biznesi per vitin 2017-2018, GVJ konstaton se, të gjithë titullarët e lëndëve kanë titujt "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" ose grade shkencore .<br><br>Rektori, Zv/Rektori, Dekani, dhe Përgjegjësi i Departamentit janë të punësuar me kohë të plotë në AU.<br><br>GVJ konstaton se kurrikula e Msc në "Admnistrim Biznesi", për periudhën per te cilen akreditohet ky program, nuk ka praktike profesionale te perfshire.<br><br>Kurrikula e re qe do te implementohet ne vitin akademik 2018-2019, ne kuadrin e ndryshimeve te bera, ka në përbërje edhe lëndën e praktkes profesionale *[Evidence, 3. Kurrikulat e propozuara 2018-2019.pdf, vizita ne institucion]* |
| **Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e | Referuar takimeve me pedagogët e këtij programi dhe me GVB, rezulton se çdo studenti që ndjek këtë program studimi, i caktohet një udhëheqës për temën e diplomës që duhet të përgatisë në përfundim të studimeve të këtij cikli.<br><br>GVJ referuar informacionit të siguruar nga vizita në AU për shpërndarjen e temave të diplomës, konstaton se udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor".<br><br>Referuar RVB por edhe informacionit të siguruar në institucion, raporti pedagog udhëheqës-student për vitin akademik 2016- |

| | |
|---|---|
| studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. | 2017, është mesatarisht 5 studentë/pedagog udhëheqës. *[Evidence, 17. Lista e temave te diplomave per studentet Master i Shkencave.pdf, Vizita ne institucion]* |

**Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. | Nga takimi me drejtues dhe stafin akademik, rezulton se studentët informohen për fushat e ekspertizës së pedagogëve përkatës, për të mundësuar një përputhje të temës së tyre me ekspertizën e pedagogut udhëheqës dhe me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br><br>Referuar shpërndarjes së temave siguruar nga vizita në institucion dhe CV te stafit, rezulton se udhëheqësit janë staf akademik i departamentit që mbulon programin Master i shkencave në "Administrim Biznesi". Këta pedagogë zotërojnë njohuri dhe aftësi teorike dhe kërkimore në fushen e administrim biznesit. *[Evidence, 17. Lista e temave te diplomave per studentet Master i Shkencave.pdf, Vizita ne institucion, CV e stafit, Dosja e vetevleresimit]* |

**Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Referuar kurrikules së programit master i shkencave ne "Administrim Biznesi", konstatohet se ky program nuk ka ore laboratorike. *[Evidence 3.6 Kurrikula Msc Administrim Biznes.pdf, Dosja e vetevleresimit]*, pavaresisht kësaj, personeli i Zyrës se IT-së është i angazhuar në mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike në auditore. Referuar struktures se AU, si dhe informacionit te siguruar gjate vizites ne AU, funksionojnë Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, të cilat janë në mbeshtetje te përmbushjes se objektivave të PS Msc ne "Administrim Biznesi".<br><br>AU dëshmon se ka një përdorim optimal të burimeve njerëzore, e cila u demonstrua nga stafi administrativ dhe ndihmes mesimor-shkencor edhe gjate vizitave ne institucion. |

**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. | GVJ duke iu referuar dokumentacionit te siguruar gjate vizites në institucion, dosjes se vetëvleresimit, vlereson se personeli akademik i PS Msc ne "Administrim Biznesi", realizon ngarkesën mesimore dhe si baze per percaktimin dhe vleresimin e kesaj ngarkese mesimore, perdoret Udhëzimin nr.20 dhe Udhëzimin nr.40.<br><br>*[Evidence 13, Ngarkesa mesimore per cdo program.pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>Referuar ngarkesës së 2017-2018, te siguruar gjate vizites ne institucion, sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të |

| | |
|---|---|
| | respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik, pasi konstatohen raste te pedagogeve qe mbulojne lende te fushes se finances dhe të manaxhimit; lende te fushes se manaxhimit dhe te Marketingut; (Investime dhe Manaxhim te burimeve njerezore, apo Manaxhim Burimesh njerezore dhe Taksim). *[Evidence 14,14.Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>Përsa i përket ngarkesës individuale semestrale dhe vjetore rezulton se në pedagogë te veçantë gjatë vitit 2017 -2018 kanë mbuluar më shumë se sa 3-4 lëndë dhe të shpërndara në disa programe studimi, ç'ka çon edhe në disbalancim ngarkese, për pjesën tjetër te stafit. *[Evidence 14,14.Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>Gjithashtu, sugjerohet, që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet formimi akademik dhe fusha e ekspertizës se stafit, pasi referuar CV-ve te stafit dhe shperndarjes se ngarkeses, GVJ konstatoi se pedagoget mbulojne lende te cilat nuk perputhen me formimin e tyre akademik. |
| **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. | Nga te dhenat e siguruara nga vizita ne institucion, konstatohet se AU, disponon nje baze te dhenave per personelin akademik te perfshire ne PS Msc. "Administrim Biznesi", ku percaktohen lektoret, lendet, oret mesimore, semestri etj.*[Evidence 14.Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>Ne ankesin e kontrates se personelit akademik konstatohet se percaktohen pervec informacioneve te tjera, edhe lendet qe do te mbulojne, programi i studimit si dhe perfshirja ne mesimdhenie e leksioneve dhe/ose seminareve<br><br>GVJ konstaton se AU përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Keto kritere sipas informacionit te siguruar ne zyren e burimeve njerezore, publikohen ne faqen zyrtare te Agjencise Kombetare te Punesimit, ne faqen zyrtare te AU si dhe ne media vizive *[Evidence 24.1 Printscreen shpallja e vendeve vakante.pdf, Vizita ne institucion]* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ prane AU, angazhohen për përmbushjen e objektivave të programit të studimit "Master i shkencave" në "Administrim Biznesi",
- Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.
- AU ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit dhe publikon njoftimet per vendet vakante. AU disponon një bazë të dhënash te detajuar për personelin e tij.
- AU deshmon se ka një përdorim optimal të burimeve njerezore, e cila u demonstrua nga stafi administrativ dhe ndihmes mesimor-shkencor edhe gjate vizitave ne institucion.

- Studentët që ndjekin programin e studimit Master i shkencave në Administrim Biznesi, kanë udhëheqës për tezën. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.
- Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në AU eshte i angazhuar për përmbushjen e misionit të tij.
- GVJ identifikoi raste te rekrutimeve te stafit akademik efektiv pa graden shkencore, ndërkohë kur ne kerkesat per rekrutim pasja e grades shkencore, paraqitet si kusht.
- Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në PS Msc ne Administrim Biznesi, mbulon 65 % të ngarkeses ne programin e studimit Msc. ne Administrim Biznesi.
- Konstatohen raste te pedagogeve qe mbulojne lende te fushes se finances dhe të manaxhimit, apo lende te fushes se manaxhimit dhe te marketingut njekohesisht;
- Përsa i përket ngarkesës individuale semestrale dhe vjetore rezulton se në pedagogë te veçantë gjatë vitit 2017 -2018 kanë mbuluar më shumë se sa 3-4 lëndë dhe të shpërndara në disa programe studimi, ç'ka çon edhe në disbalancim ngarkese, për pjesën tjetër te stafit.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, i konsideron **standardet e kësaj fushe, pjesërisht të përmbushur**

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron nje rritje te angazhimit te stafit akademik efektiv ne kete PS.*
- *Referuar ngarkesës së 2017-2018, sugjerohet që në shpërndarjen e ngarkesës, të respektohet fusha e ekspertizës dhe e kualifikimit të stafit akademik. GVJ sugjeron rritjen e perputhshmerise mes formimit akademik te stafit te rekrutuar si dhe disiplinave që ata mbulojnë;*

## 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

**Pjesa përshkrimore**

> ***Terma reference:*** *mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.*

Universiteti Privat "Albanian University" disponon 4 godina ne funksion te programeve te studimit. Lokacioni i AU eshte në qendër të kryeqytetit dhe pranë godinave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera për studentët. Departamenti i Shkencave Ekonomike ndodhet ne godinën qendrore ne Bulevardin "Zogu I", me një sipërfaqe prej 3996 m2. Ndërtesa ku Departamenti i Shkencave Ekonomike zhvillon proceset akademike dhe administrative, eshte nje godine egzistuese e cila eshte rikonstruktuar dhe eshte pershtatur ne auditore per mesimdhenien dhe ne ambiente zyrash dhe sherbimesh administrative. Auditorët janë të pajisura me video projektor dhe kompjuter. Shërbimi i internetit ofrohet ne te gjitha ambientet e kesaj godine. Salla e bibliotekës disponon një numër te limituar postesh leximi, me një numer te vogel kompjuterash dhe ne nje hapesire e cila ka nevoje te permiresohet persa i perket kushteve fizike.

Literatura profesionale kryesisht në gjuhën angleze dhe shqipe. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të kërkimit të pedagogëve. Shërbimi i bibliotekes, realizohet prej punonjësve te saj dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Studentet regjistrohen përmes kartës së regjistrimit dhe mund të aksesojnë literaturë si në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj në ambientet e bibliotekës.

GVj nga vizita qe pati ne mjediset e bibliotekes, konstatoi se numri fizik i kartelave te studenteve te programeve te studimit te fushes se ekonomise paraqitej i vogel, krahasur me numrin e studenteve të rregjistruar në keto programe. Referuar vizites ne institucion dhe takime me drejtues te njesise kryesore dhe baze, konstatohet se AU çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Referuar RVB, në fondin e bibliotekës numërohen rreth 1200 libra të titujve të ndryshëm. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore-shkencore. Konstatohet se stafi akademik dhe studentet kane mundesi aksesimi ne biblioteken on line QUESTIA pa pagesë, në funksion të mesimdhenies dhe kërkimit shkencor. AU boton revisten shkencore OPTIME - në të cilën botohen të gjithë punimet shkencore në kuadër të përmbushjes së kërkesave për kërkime dhe punime shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve sipas fushave te ndryshme, ne te cilat AU ka programe studimi.

Gjithashtu 'Albanian University Press' - ndërmarrja botuese pjesë e "Universitetit Privat "Albanian University" ka botuar të gjithë librat në kuadër të përmbushjes së kërkesave për tekste mësimore dhe shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. AU ofron edhe sherbime te tjera mbeshtetese, sic eshte shërbimi i fotokopjes që ndodhet në librarinë e universitetit dhe mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët.

Gjithashtu kanali televiziv kombëtar UTV - pjesë e "Universitetit Privat "Albanian University"", i sherben promovimit te institucionit dhe programeve te tij te studimit si dhe zgjerimin te spektrit të tyre të dijeve dhe përvetësimit të informacioneve të reja ne lidhje me drejtimet ku ata studiojne.

AU diponon Sallen e Konferencave, e pajisur me teknologji multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave dhe aktiviteteve te tjera te ketij standardi.

Ne kete godine, jane te integruara edhe nje teresi sherbimesh te tjera si kafeteri/fast-food – si dhe vetëshërbimi ushqimor për të gjithë studentët e AU në këtë ndërtesë dhe qe konsiderohet facilitet për studentet.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Mjediset për Programin e studimit (Tabelat 6 dhe 7 në Aneks)

Të dhëna për mjediset ne dispozicion të programeve të studimit që AU ka paraqiten në tabelën 6, në shtojcën bashkëlidhur. AU dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programit të studimit, të përbërë nga 10 salla leksionesh, 20 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjegjësin e njësisë bazë etj. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të proçesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, dhe kompjutera. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për programin e studimeve.

☑ Mjediset për stafin:

Te dhënat me poshtë janë marre nga tabela 7, ne shtojcën bashkëlidhur, referuar te dhënave te siguruara nga RVB dhe te verifikuara gjate viztes ne institucion

- Mjedise për Dekanin 1
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet 1
- Zyra për personelin akademik 1

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;<br><br>**Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;<br><br>**Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj. | Referuar RVB dhe vizitës ne institucion, AU disponon ka katër godina të ndara sipas fakulteteve përkatëse. Departamenti i Shkencave Ekonomike e zhvillon procesin e tij mësimor në mjediset e selisë qendrore të AU, me një sipërfaqe totale prej 3996 $m^2$.<br><br>AU dëshmon se i disponon këto mjedise me kontrata të përsëritura prej vitit 2006.<br><br>Pavaresisht se AU disponon 4 godina, programi i studimit Msc. në Administrim Biznesi zhvillohet vetëm në godinën e selisë qendrore te AU.<br><br>Ky kriter nuk eshte relevant per kete program studimi |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;<br><br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;<br><br>**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. | GVJ referuar edhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se AU siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. GVJ sugjeron që kjo literaturë të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive, referuar këtu programeve të lëndëve dhe literatures se parashikuar ne to.<br><br>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e AU, ka literaturë që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Duke qene se AU siguron akses ne biblioteka on-line per stafin dhe studentet, kjo rrit mundesine e sigurimit te nje literature bashkekoheore, por GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë te shtypur cilësore të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që programi Master i shkencave në Administrim Biznesi ka.<br><br>Sipas GVB por edhe informacionit te siguruar gjate vizites ne AU GVJ konstaton se përgjegjësit e programeve dhe pedagogët, janë të angazhuar për pajisjen e bibliotekës me tekstet mësimore dhe literaturës së fundit *[Evidence 42, 4.2.Kerkese e Departamentit per fondin e bibliotekes.pdf, Dosja e vetevleresimit]*<br><br>Referuar GVB, por edhe informacionit të siguruar nga personeli i bibliotekës gjatë vizitës në institucion, rezulton se orari i bibliotekës është 08.00-16:00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br><br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e | Referuar RVB si dhe vizitës se mjediseve te AU, GVJ konstaton se AU disponon klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. AU dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programit të studimit, të përbërë nga 10 salla leksionesh, 20 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që |

| | |
|---|---|
| nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike. | mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjegjësin e njësisë bazë etj. *[Tabela 6, tabela 7 shtojca bashkëlidhur].* GVJ referuar tabelave 6 dhe 7, sugjeron shtim te ambienteve per stafin akademik te departamentit, duke qene se ky department ka ardhur duke u zgjeruar ne vite dhe aktualisht ka 28 pedagoge, nderkohe qe nga RVB, raportohen 2 zyra, 1 per departamentin dhe 1 per stafin akademik te departamentit, te konsideruara te pamjaftueshme per akomodim te nje stafi te tille.<br><br>Programi nuk permban praktika, por AU ne godinen ku zhvillohen proceset mesimore te PS Msc. ne Admnistrim Biznesi, ka 1 laborator informatike me kapacitet prej 30 personash, dhe që përdoret për lëndët "Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit", "Metoda Kërkimi dhe Ekonometri" Ky laborator nëpërmjet programeve të instaluara "Microsoft Office", "Programi Bilanci" dhe "UMS" ndihmon studentët për punët dhe detyrat që kanë në programin e secilës lëndë apo edhe në temat e diplomave. Pavarsisht, se sipas një skedulimi normal të orarit të punës, laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, GVJ sugjeron shtim te laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike ne kete godine, duke qene se ketu zhvillojne proceset mesimore disa fakultete dhe shume programe studimore te nivelit master dhe bachelor. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- AU siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit "Master i shkencave" në Administrim Biznesi.
- AU vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij, ne te cilën mund te shfrytëzohet edhe fondi i bibliotekave elektronike, ne te cilat AU eshte e regjistruar.
- AU vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, pavar`sisht nga sugjerimet konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur kryesisht**

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron shtim te laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike ne godinen kryesore, duke qene se ketu zhvillojne proceset mesimore disa fakultete dhe shume programe studimore te nivelit master dhe bachelor.*
- *GVJ sugjeron që AU te intensifikoje perpjekjet per perditesimin e literaturës dhe shtimin e fondit te bibliotekes, me botimet e fundit të fushave respektive qe lidhen me kurrikulen e Ps Msc. ne Administrim Biznesi*
- *GVJ sugjeron shtim te ambienteve per stafin akademik te departamentit, duke qene se ky department ka ardhur duke u zgjeruar ne vite dhe mjediset aktuale te parashikuara per kete staf, konsiderohet te pamjaftueshme*

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

Referuar Tabelës 8 ne shtojcën bashkelidhur, të siguruar nga RVB, institucioni paraqet të ardhurat dhe financimet për vitet akademike nga 2012-2013 deri për 2017-2018 ne nivel institucioni. Këto të ardhura, janë siguruar nga të ardhurat nga tarifat e shkollimit si dhe nga aktivitetet tregëtare.

Për vitet 2012-2013, 99.4% e te ardhurave vijne prej tarifave te shkollimit dhe 0.6% vijne nga sherbimet tregetare. Per periudhën 6 vjecare per te cilen behet akreditimi, referuar Tabeles 8 ne shtojce, GVJ konstaton nje rënie te te ardhurave nga tarifat per studimin, një rritje e te ardhurave nga sherbimet tregetare ne vitet e fundit, por nje renie të të ardhurave totale të institucionit nga viti ne vit.

Në AU ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre. Sipas RVB dhe informacionit te siguruar gjate takimit te zhvilluar me GVB, AU ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Raportet e hollësishme të këtyre auditeve janë të disponueshme në Zyrën e Financës të AU dhe nje permbledhje e ketyre dokumentacioneve ne vite ju vendos GVJ ne dispozicion mbas kerkeses gjate vizites ne institucion npermjet sistemit AMS. *[Evidence 10, Raporti i Auditit te Jashtem.pdf, Vizita ne institucion]*

GVJ vlereson si praktike, heqjen e tarifës së regjistrimit për të gjithë studentët dhe mos aplikimi i tarifave të tjera shtesë për provimet në sesionin e parë. Studentët paguajnë vetëm tarifën e programit të studimit, nuk ka pagesë ekstra për aplikimin fillestar dhe regjistrimin përveç tarifës së studimeve.

GVJ vlereson praktiken e ndjekur nga institucioni qe pervec certifikimit te pasqyrave financiare nga audituesi i pavarur, AU ka ne strukturen e vet edhe zyrën e auditit të brendshëm qe realizon kontrollin dhe auditimin e brendshëm qe funksionon pranë Zyrës të Financësdhe dhe varet nga Bordi i Administrimit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- AU **nuk** ka te ardhura nga grantet për kërkim per te gjithë periudhën e akreditimit
- Konsulencat, shërbimet, donacionet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar 99.4% të ardhurave gjatë 2012-2013, 99.8% per 2013-2014 dhe 99.7% per vitin 2014-2015, 96,6 % per 2015-2016, 96,6% per 2016-2017, 96.9% per 2017-2018
- Sponsorizimet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Shërbimet trainuese **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Donacionet, aktivitetet siguruese etj **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2018.
- Aktivitetet tregtare kanë siguruar 0.6 % të ardhurave gjatë 2017 dhe 2018

GVj konstaton nga analiza e shifrave te tables 8 dhe nga përqindjet e siguruara, se kryesisht te ardhurat per AU, realizohen ne masën mbi 96% per te gjithë periudhën e akreditimit, nga tarifat e studimit. Grantet, projektet, donacionet dhe konsulencat nuk sigurojnë te ardhura.

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar RVB dhe informacionit te siguruar gjate takimit me GVB, konstatojmë se shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja e raportuar nga

institucioni për një student në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, llogaritet 125000 lekë/vit akademik.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizites ne institucion GVJ paraqiti kerkesen per informacion mbi raportet e auditimit te AU. Ky informacion per vitin fiskal 2017, u vu ne dispozicion nga institucioni, dhe u konsultua nga GVJ permes sistemit AMS.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.** | |
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br>**Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br>**Kriteri 3** Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. | Referuar RVB, si dhe informacionit te siguruar gjate vizitës ne institucion, AU ka raport auditi çdo vit. Opinioni i auditit, që iu vendos në dispozicion GVJ-së, gjatë vizitës në institucion, shprehet se pasqyrat financiare të AU, paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2017, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në perputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. *[Evidence 10, Raporti i Auditit te Jashtem.pdf, Vizita ne institucion]*<br>Ne lidhje me kete kriter, GVJ referuar tabelave te financiare te siguruara nga institucioni konstaton se AU nuk përfiton financime nga asnjë grant dhe nuk ofron sherbime nga te cilat mund te sigurojnë te ardhura<br>Raporti i auditit analizon efiçencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve të ciklit të dytë të studimeve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në ciklin e dytë. |
| **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. | GVJ, konstaton se në RVB, paraqiten kosto/student ne nivel programi studimi. Referuar RVB dhe informacionit te siguruar gjate takimit me GVB, konstatojmë se shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja e raportuar nga institucioni për një student në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, llogaritet 125000 lekë/vit akademik.<br>GVJ konstaton prej informacionit të paraqitur në RVB, se ka ardhur në rënie numri i studentëve që ndjekin këtë program, gjithashtu edhe te ardhurat totale te institucionit kane ardhur vazhdimisht ne rënie, duke qene se ato janë te financuara ne masën mbi 96% nga tarifat e studimit dhe se deri tani institucioni nuk ka siguruar diversifikim te burimeve te financimit nga grantet, projektet, konsulencat apo donancionet. Per te ardhmen GVJ sugjeron diversifimin e burimeve financiare, jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe qe kane ardhur duke u |

| | |
|---|---|
| | zvogëluar, por edhe nga burime te tjera te tjera te lartpërmendura, te cilat pervcse krijojnë mundësi te tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe ne kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes se kontributit institucional ne komunitetin shkencor |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- AU harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.
- AU bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare dhe te qëndrueshmërisë financiare

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe përmbushen kryesisht.**

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron **diversifimin e burimeve financiare**, jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe që kane ardhur duke u zvogëluar, por edhe nga **burime te tjera te tjera** si grantet, konsulencat, projektet, të cilat përveç se krijojnë mundësi te tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe ne kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes se kontributit institucional ne komunitetin shkencor*

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

***Terma reference:*** *institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

Njesia e Sigurimit te Brendshem te cilesise ne AU, referuar dokumentacionit ne sistemin AMS, konstatohet se është institucionalizuar me Vendim Senati Akademik në 23/07/2010 dhe me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë ne perputhje LAL.

GVJ nga infomracioni i siguruar nepermjet sistemit AMS, nga RVB si dhe nga takimet me perfaqesues te NJSBC, konstaton se NJSBC finalizon aktivitetin e saj me paraqitjen e një raporti vjetor per vlerësimin e procesit te mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Ky raport pasi paraqitet në Senat Akademik, miratohet dhe publikohet në faqen zyrtare web. NJSBC ka funksione mbështetëse, këshillimore, bashkërenduese, monitoruese dhe administrative me strukturat e tjera akademike dhe administrative të AU.

Gjatë aktivitetit të vetë NJSBC në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin Institucional, ajo harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. GVJ vlerëson praktiken e ndjekur nga AU që për ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë edhe ne nivel njesie baze qe prej vitit 2016. Në nivel njesie baze, analizohen dhe vleresohen programet mesimore, litarturat dhe format e vleresimit te cilat paraqiten te standardizuara. NJSBC kontrollon dhe vlereson duke u mbeshtur mbi nje metodologji që perdor pyetësoret dhe fokus grupet, raportet e vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësive bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. GVJ siguroi te dhena rreth ketyre formave te vleresimit, nga informacioni i arkivuar nga institucioni si dhe nga informacioni shtese i siguruar gjate vizites ne institucion. NJSBC ne baze te informacionit primar dhe sekondar, harton raporte te cilat i drejtohen rektorit si dhe senatit akademik. Keto raporte permbajne rezultatet e vleresimit , identifiimin e problematikave si dhe rekomandimet e metejshme.

## Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Gjatë takimeve me NJSBC, GVJ-së iu vendos në dispozicion informacion mbi mënyrën e funksionimit, rregulloren e saj, planin e veprimit, format e pyetsorëve të kryer etj.

GVJ konstaton, nga komunikimi me NJSBC se për vlerësimin e programit të studimeve përdor metoda alternative, ku përvec pyetsorëve organizohen dhe fokus grupe me studentët, për të siguruar informacion shtesë, informacion më cilësor, dhe për të shmangur asimetrinë e informacionit. Pyetesoret rezulton se aplikohen dy here ne vit, ne përfundim te cdo semestri. Pergjigjesisht norma e pjesëmarrjes ne këto pyetësorë arrin nga 50% -57% e studenteve.

Duke qene se programi i studimit, Msc. ne Administrim Biznesi ka numër te kufizuar te studenteve, sugjerohet qe NJSBC te përdor mekanizma qe rrisin pjesëmarrjen e studenteve, qe te sigurohet nje informacion me i plote por edhe qe te mos ndikohet rritja e subjektivizmit;

☑ Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Mbas njohjes me RVB si dhe takimit me NJSBC, rezulton se NJSBC ne nivel njësie baze ka në përbërje të saj 6 anëtarë, të cilët kane ne kete detyre me pak se 2.5 vite *[Tabela 9, shtojca bashkëlidhur]*

☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ne AU rezulton se kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nga Komisioni për Vlerësim Institucional (një nga anëtarët e Komisionit është personel akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Ekonomike).

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizitës ne AU, GVJ-se në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, iu vendosen në dispozicion dokumentat e kërkuar, te cilët u shqyrtuan në funksion të konkluzioneve te nxjerra për këtë rubrike si; *Evidence 39.a shkrese fokus grupe.pdf; Evidence 39.b Pergjigje shkreses se shkreses (2).pdf; Evidence 40.a Shkrese RV.pdf; Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf; Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf; Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf; Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE MSc.pdf; Evidence 29.1 Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE MSc.pdf etj*

## Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.<br><br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; | GVJ nga analiza e dokumentacionit te siguruar gjate vizites ne AU përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit te studimit Msc. ne Administrim Biznesi, si pyetesoret dhe fokus grupet [*Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf*]<br><br>GVJ konstaton se rezultatet e siguruara nga NJSBC, kjo njesi i perfshin ne raportet vjetore qe realizon, ku identifkohen problematikat dhe paraqiten dhe rekomandimet [*Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf; Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf*]<br><br>Dokumentacioni i vënë ne dispozicion nga AU per GVJ, |

| | |
|---|---|
| c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><u>Të drejtpërdrejta:</u><br>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;<br>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;<br>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; | demostron se AU I publikon ne web sitin zyrtar rezultatet e vleresimit ne menyre te permbledhur si dhe pritshmerite per te ardhmen *[Evidence 41. Pritshmëritë pë v.a. 2018-2019.pdf, https://Albanian university. edu.al/sq/ sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/*<br><br>GVJ nga takimet me drejtues te njesise baze, perfaqsues te NJSBC si dhe me stafin e programit, konstaton se AU perdor per vlerësimin metoda të tërthorta dhe të drejtëpërdrejta si:<br><br>Pyetesore me studentet dy here ne vit, fokus grupe me ta, forma te vetevleresimit te PAE dhe PAK si dhe vleresimet e drejtuesit te njesise baze pe PAE dhe PAK si dhe rezultatet e studenteve ne provimet e lendeve, kalueshmeria, nota mesatare etj *[Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf; Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE MSc.pdf; Evidence 29.1 Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE MSc.pdf]* |

**Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. | GVJ konstaton se ne faqen zyrtare te institucionit gjenden te publikuara strategjia, politikat dhe raporti i NJSBC<br><br>GVJ nuk identifikoi ne faqe prezantime interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. |

**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | Nga informacioni i siguruar gjate vizitës ne institucion, GVJ konstaton se mbeshtetur mbi nje metodologji vleresimi, NJSBC harton nje raport vjetor, ku vleresohet ecuria e programeve te studimit, qe departamenti ka, mbi baze shumefaktoreshe *[Evidence, 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf ]*<br><br>GVJ identifikoi ne planin strategjik te institucionit, te njesise kryesore dhe asaj baze, si nje nder objektivat kryesore përmirësimin e cilësise ne programet e studimeve si dhe planin e veprimit per ta garantuar kete. *[Evidence 15, R.a.2.Plani Strategjik i Zhvillimit te Institucionit 2017-2022.pdf]* |

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; | AU është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional, duke e kaluar pozitivisht me kohëzgjatje 2 vjeçare, shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017<br><br>GVJ vlereson se AU perdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, duke garantuar qe NJSBC te |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br><br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | funksionoje deri ne nivel njesie baze dhe duke perdorur metodologji qe kombinon nje larmishmeri formash si pyetesore, focus grupe, forma vleresimi nga drejtuesit dhe vetevlersimin.<br><br>Për GVJ rezulton se AU përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme qe konsistojne ne hartimin e raportit nga NJSBC, shqyrtimi ne senatin akademik, miratimin e tij dhe lenien e rekomandimeve per te ardhmen. [*Evidence 39.a shkrese fokus grupe.pdf; Evidence 39.b Pergjigje shkreses se shkreses (2).pdf; Evidence 40.a Shkrese RV.pdf; Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf; Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf]*<br><br>Pavarësisht formalizimit të procesit të vlerësimit nga AU dhe mekanizmave formal që përdor, GVJ mbështur ne mungesen e informacionit nga takimet me studente te programit master, sugjeron intensifikimin e proceseve informuese nga ana e institucionit, me qëllim ndërgjegjësimin e studenteve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në programin e studimit qe ata ndjekin, si dhe integrimin më të plotë të këtyre studenteve ne proceset e vleresimit<br><br>GVJ konstaton se AU ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar |

<u>**Konkluzionet e vlerësimit:**</u>

- AU përdor një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.
- AU kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.
- GVJ sugjeron që institucioni të publikojë rregullisht broshura, buletine, prezantime në faqe internet, video e audio, mbi vlerësimin e brendshëm.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe permbushen**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

## 7. Programi i studimit, organizimi i tij

**Pjesa përshkrimore**

***Terma reference:*** *misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Administrim Biznesi" është licencuar me VKM nr. 56, datë 21.01.2009 dhe është akredituar për herë të parë me vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 355, datë 13.07.2012. Pasi i konsultua më Rregulloren e Programit dhe takimet me stafin, dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se ky program studimi ka si objektiva:

- ✓ Të prezantojë studentët me studime të thelluara të fushës së menaxhimit dhe biznesit në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ✓ Të ndihmojë studentët të zhvillojnë më tej karrierën e tyre nëpërmjet zhvillimit dhe përmirësimit të njohurive dhe shprehive në fushën e administrimit të biznesit; □ Të aftësojë studentët në procesin e vendimmarrjes efektive, nëpërmjet ofrimit të njohurive dhe shprehive përkatëse;
- ✓ Të udhëheqë studentët drejt përfitimit të shprehive të të mësuarit që do t'i ndihmojnë ata të jenë të suksesshëm në një ambient biznesi gjithnjë në ndryshim;
- ✓ Të zhvillojnë aftësi menaxheriale nëpërmjet përballjes me situata të ndryshme ku kërkohet zgjidhja e problemeve, dhe të mësuarit nëpërmjet praktikës;
- ✓ Të udhëheqë studentët drejt punës kërkimore si pjesë e programit mësimor të lëndëve pjesë përbërëse e programit të studimit, por edhe gjatë përgatitjes së temës së diplomës.

Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", zhvillohet në dy vite akademike dhe ofron 120 kredite (Tabela 10 në Anekse), në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Numri i lëndëve që përbëjnë këtë program studimi është 14 si dhe teza e diplomës.

Lëndët ndahen në 2 lëndë të formimit bazë, 7 lëndë të formimit karakterizues, 2 lëndë të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese, 2 lëndë me zgjedhje, 1 lende veprimtari formuese informatikë, si dhe tema e diplomës. Modulet e programit vlerësohen kryesisht me 6 ECTS, nderkohe qe nje lende vlerësohet me 7 ECTS dhe 1 lende me zgjedhje e vitit te pare vlerësohet me 5 ECTS. Tema e diplomes ka 36 ECTS.

Plani mësimor i programit bën një ndarje të lëndëve të detyrueshme, 5 për çdo semestër të vitit te pare, semestri i trete 5 lende, ndërsa semestri i katërt i kushtohet vetëm punimit të diplomës.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Administrim Biznesi është licencuar me VKM nr. 56, datë 21.01.2009 dhe është akredituar për herë të parë me vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 355, datë 13.07.2012.

☑ Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- ➢ 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- ➢ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- ➢ Cdo vit ka 2 semestra
- ➢ Ora e mesimit eshte 50 minuta

☑ Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor për pogramin "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", jepet ne Anekse, Tabela 10 dhe Tabela 11.

☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10-12 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit

- Për Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar/Diploma 3 orë në auditor dhe 22 orë punë e pavarur e studentit

☑ Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12 ne Aneks)

Sic u konstatua nga takimet ne institucion por edhe nga dokumentacioni i dosjes se vetëvlerësimit, plani mësimor është rishikuar me Vendim të Këshillit të Fakultetit nr. 1, datë 07.09.2015, dhe ne në bazë të sugjerimeve të një grupi pune me ekspertë të fushës. Ndryshimet në plan janë bërë brenda normave të lejuara nga MASR. *[Tabela 12, shtojca bashkëlidhur]*

Departamenti ka përshtatur planin me legjislacionin në fuqi, konkretisht me VKM nr. 41, datë 24.01.2018. MASR ka miratuar ndryshimet në kurrikulën e këtij programi studimi dhe për vitin akademik 2018-2019 do të implementohet plani mësimor sipas akteve ligjore në fuqi.

Konstatohet se gjate kësaj periudhe praktika mesimore nuk ka qene pjese e kësaj kurrikule. Nga informacioni i siguruar gjate vizites ne institucion, GVJ konstaton se ne kurrikulen qe do te implementohet gjate vitit akademik 2018-2019, janë bere ndryshime ne përmbajtje dhe ne kreditet/lende. *[Evidence 3. Kurrikulat e propozuara 2018-2019.pdf].* GVJ konstaton se ne kete kurrikule do te përfshihet praktika deri tani e munguar, dhe do te kete 12 kredite e cila bashke me temën e diplomës me 18 kredite do te zhvillohen ne semestrin e katërt. Nderkohe edhe 3 lende kane pësuar ndryshime ne kredite duke kaluar nga 6 kredite ne 8 dhe 7 kredite.

GVJ, duke bërë një analizë të ndryshimeve të ndodhura në planet mësimore, krahasuar me ato që kanë qënë, arrin në përfundimin se planet mësimore aktuale kanë për qëllim aftësimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e Menaxhimit. GVJ konkludon se ndryshimet e ndodhura kanë përmirësuar kurrikulën e studimeve për këtë program studimi duke siguruar nje lidhje me te forte te teorisë me praktiken.

☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13 në Aneks)

Plani mësimor i lidhur me stafin akademik qe mbulon cdo lende per vitin 2017-2018, jepet ne tabelën 13 ne shtojcën bashkëlidhur

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelën 4.1 4.3, shtojca bashkëlidhur. 100% e Stafit të përfshirë në këtë program studimi, gjatë vitit 2017-2018 janë me tituj akademike ose grade shkencore *[Tabela 4.1, 4.2]*.

☑ Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe intervistat e kryera me stafin akademik, u vleresua roli që kishte udheqesi i cdo lënde në ndërtimin e syllabusit dhe mënyra e ndryshimit të tyre. U konstatua se syllabuset ishin të pandryshura për sa kohë përgjegjesi i lëndes kishte ndërmarre ndryshime të syllabusit në vitin e parë të mësimdhënies. Këto ndryshime bëheshin në Departament përpra fillimit te vitit shkollor. Forma e syllabuseve ishte standarte për të gjitha lëndet. Syllabusi përmban këto elementë kryesorë,

- Emertimin e lendes
- Numri i krediteve
- Emri i udheheqësit të lëndës
- Përshkrimi i lëndës
- Objektivat e lëndës
- Temat qe përmban lënda
- Teksi kryesor dhe literatura mbështeteëse
- Refeneca të tjera literature

- Rezultatet dhe qellimi i programit të lëndes
- Metodat e vlerësimit dhe pesha e tyre

☑ Analizë e cilësisë së syllabuseve

Ne lidhje me cilësinë e syllabuseve GVJ konstaton se ne disa prej lendeve literatura eshte literature qe perdoren kryesisht ne programet e studimit te nivelit bachelor, sic eshte ajo e lendes Manaxhimit te Marketingut dhe Biznesit nderkombetar, e Manaxhimit te Projekteve, e Sipermarrjes se Biznesit te vogel, e lendes se Manaxhimit te Burimeve njerezore, e lendes se Finances se Korporatave.

Kryesisht syllabuset kane literature, e cila eshte relativisht e vjeteruar dhe kërkon azhornim

Konstohen raste te syllabuseve qe nuk janë ne përputhje me emërtesën e lendes sic eshte lënda Sjellje Organizative dhe Etike, ne programin e se cilës përmbajtja dhe literatura mbulojnë vetëm etiken e biznesit, nderkohe qe per sjelljen organizative nuk parashikohen tema ne program, lënda Manaxhimit i avancuar i prodhimit dhe operacioneve per te cilen nuk perputhet literatura me emërtimin e lendes.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); | GVJ konstaton se programi i studimit Msc. ne Administrim Biznesi, eshte i organizuar ne module dhe i vleresuar sipas sistemit ECTS *[Tabela 10, shtojca bashkelidhur]* |
| **Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Nga plani mesimor konstatohet se cdo semester ka disiplina qe kane 30 kredite, dhe ne cdo vit 60 kredite |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;<br><br>**Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;<br><br>**Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;<br><br>**Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura"dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;<br><br>**Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë | PS Master i Shkencave në Administrim Biznes është konceptuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjine e institucionit, për ti përgatitur studentët që kanë mbaruar studimet Bachelor, me njohuri të thelluara në fushën e manxhimit të biznesit në drejtimin teorik ashtu edhe atë praktik. Ne lidhje me kete kriter GVJ konstaton se kurrikula e ketij PS, nuk permban praktike e cila do ti sherbente trajnimit te mirefillte profesional te studenteve<br><br>PS i studimit gjithashtu afron mundësi që studentët të kryejne studimeve të aplikueshme për sektorë të ndryshëm të biznesit në Shqipëri, duke synuar ti përgatise këta studente me kompetenca profesionale<br><br>GVJ konstaton se ne disa prej lendeve literatura eshte literature qe perdoren kryesisht ne programet e studimit te nivelit bachelor, sic eshte ajo e lendes Manaxhimit te Marketingur dhe Biznesit nderkombetar, e Manaxhimit te Projekteve, e Sipermarrjes se Biznesit te vogel, e lendes se Manaxhimit te Burimeve njerezore, e lendes se Finances se Korporatave.<br><br>Kryesisht syllabuset kane literature e cila eshte relativisht e vjeteruar dhe kërkon azhornim<br><br>Konstohen raste te syllabuseve qe nuk janë ne përputhje me emërtesën e lendes sic eshte lënda Sjellje Organizative dhe |

| | |
|---|---|
| objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | Etike, ne programin e se cilës përmbajtja dhe literatura mbulojnë vetëm etiken e biznesit, nderkohe qe per sjelljen organizative nuk parashikohen tema ne program, lënda Manaxhimit i avancuar i prodhimit dhe operacioneve per te cilen nuk perputhet literatura me emërtimin e lendes.<br><br>Nga vizita në institucion e GVJ dhe nga analiza qe iu eshte bere syllabuseve te lendeve, u konkludua se ky program ka nevoje per tu perfshire ne disa ndryshime qe studentet qe perfundojne kete program te jene me konkurrues ne tregun e punes si dhe përgatitjen e tyre për ciklin e tretë të studimeve<br><br>GVJ konstaton se objektivat e ketij programi jane te deklaruara, te qarta dhe te arritshme nepermjet nje strategjie te mireorientuar nga rezultatet |
| **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;<br><br>**Kriteri 2** Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve. | GVJ konstaton se duke qene se ky program studimi eshte program i studimeve master i shkencave, edhe objektivat e tij synojne pajisjen e studenteve me njohuri te thelluara teorika praktike te fushes se manaxhimit, ne vazhdim te studimeve te nivelit bachelor<br><br>GVJ nga studimi i syllabuseve te lendeve, konstaton se format e vleresimit jane te standardizuara ne raportin 60% vleresimi perfundimtar dhe 40% vleresimi semestral, te cilat i sherbejne sigurimit te evidencave per arritjet gjithsesmestrale te studenteve. Referuar takimit me stafin akademik, GVJ sugjeron vendosjen e nje diapazaoni me te gjere ne format e vleresimit, per te lejuar nje fleksibilitet me te larte ne format e vleresimit, kjo ne perputhshmeri me natyren e lendeve |
| **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. | PS i Masterit te Shkencave në Administrim Biznesi është krijuar nga përvoja më e mire e stafit akademik dhe praktikat me te mira ne vend dhe ne perputhje me marreveshjen e Bolonjes<br><br>GVJ konstaton se mënyra e vlerësimit për cdo lëndë, percaktimi i krediteve, deklarimi i objektivave dhe rezultateve te pritshme, diploma e leshuar e shoqeruar me suplemetin, e bejne kete program me konkurrues dhe lehtesojne transferimin e studenteve.<br><br>Programi merr parasysh kriteret ligjore shqiptare dhe është teknikisht i përputhur edhe me Sistemin e Bolonjës. |
| **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;<br><br>**Kriteri 3** Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të | Ky PS synon qe te permiresoje aftësite dhe kompetencat profesionale dhe kërkimore që përfitohen prej programit nepermjet njohurive ne disiplina te tilla si Metodat e kerkimit dhe Ekonometri etj. Konstatohet se PS Master i Shkencave ne Administrim Biznesi, nuk permban praktike qe do ti sherbente aftesimit profesional te studenteve |

| | |
|---|---|
| studimeve;<br><br>**Kriteri 4** Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij. | GVJ konstaton se PS dhe kurrikula e tija konstatohen se eshte ne perputhje me profilin e IAL si dhe me planin strategjik te tij *[Evidence, R.a.2.Plani Strategjik i Zhvillimit te Institucionit 2017-2022.pdf]*<br><br>GVJ konstaton nje angazhim optimal te stafit akademik te programit per te realizuar jo vetem proceset mesimore por edhe perfshirjen ne aktivitetet kerkimore shkencore.<br><br>GVJ sugjeron qe institucioni te rrise mbeshtetjen financiare per stafin akademik, per perfshirjen e tyre ne kerkimin shkencor, me qellim qe puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve, te kete perputhshmeri me te larte me qellimet qe institucioni ka |
| **Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj. | N/A |
| **Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | GVJ mendon se PS master i shkencave ne Admnistrim Biznesi, synon pergatitjen e administratoreve te biznesit me kompetencat e kërkuara nga tregu i punës<br><br>GVJ nga konsultimi i informacionit ne sistemin AMS, konstaton se njesia kryesore pergjegjese per kete program studimi, ka bere nje studim tregu ne vitin 2016, per te diplomuarit, ku perfshihet dhe perceptimi i punedhenesve i siguruar nepermjet te dhenave sekondare si dhe primare te siguruara nepermjet pyetesorit. *[Evidence, R.b.1.1.Studim i tregut per te diplomuarit.pdf, Evidence R.b.1.2.Pyetesor Studimi i tregut.pdf, Dosja e vetevleresimit]* |
| **Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | Programi i studimeve "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe tenton ruajtjen e vlerave kulturore. |
| **Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike; | GVJ konstaton nga shqyrtimi i kurrikules se PS Msc ne Administrim Biznesi (Tabela 10, 11) konstatohet se programi ka 120 kredite, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe studimet perfundojne me marrjen e diplomës "Master i Shkencave" *[Evidence 7.6.a.Model Diplome.pdf, Evidence 7.6.c.Model Suplementi.pdf, Dosja e vetevleresimit]*.<br><br>Ne kurrikulën aktuale teza përfundimtare ka 36 ECTS. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2** Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike. | N/A |
| **Kriteri 3** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë). | N/A |
| **Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;<br><br>**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. | Nga takimi qe GVJ pati me stafin e programit, rezulton se ata shperndajne informacionin rreth programit dhe syllabuseve ne senacen e pare mesimore, por keto informacione studentet mund t'i konsultojne edhe nepermjet web sitit zyrtar te AU<br><br>*(http://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-ishkencave-ekonomike/).*<br><br>Nga takimi me perfaqesues te zyres per informim te studenteve dhe nga RVB, rezulton se studentët informohen mbi kalendarin akademik, programin mësimor, lëndët , pedagoget ambientet, sherbimet mbeshtetese, te drejtat dhe detyrimet e tyre etj. |
| **Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.** | |
| **Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;<br><br>**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | Nga konsultimi i informacionit ne sistemin AMS, per GVJ rezulton per studentet ofrohet informacion i plote per mënyra e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar *[Evidence 1.1.Rregullore e programit te studimit MSc ne Administrim Biznesi.pdf; Evidence7.6.b.Model liste notash.pdf; [Evidence 7.6.a.Model Diplome.pdf; Evidence 7.6.c.Model Suplementi.pdf, Dosja e vetevleresimit]*<br><br>Referuar planit mesimor, konstatohet se per prjektin kerkimor jane parashikuar 36 kredite *[Tabela 12]* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ, lidhur me standartet e kërkuara në "Programin e studimit dhe organizimin e tij" konstaton se AU ka organizuar një program studimesh të nivelit të dytë në përputhje dhe konform standarteve ligjore në fuqi.
- Ky program studimesh është në përputhje më misionin dhe vizionin e institucionit si dhe në mbështetje të strategjisë për zhvillim që institucioni ka. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 80, datë 21.09.2015, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- GVJ konstatoi se AU ka realizuar analizë tregu per pozicionimin e diplomuarve ne tregun e punes.
- Informimi i studentëve që ndjekin këtë cikël studimesh behet nëpërmjet formave alternative.
- GVJ konstaton se kurrikula e ketij PS, nuk permban praktike e cila do t'i sherbente trajnimit te mirefillte profesional te studenteve
- GVJ konstaton se ne syllabuset e lendeve:
    - o disa prej lendeve literatura eshte literature qe perdoren kryesisht ne programet e studimit te nivelit

bachelor

- Kryesisht syllabuset kane literature e cila eshte relativisht e vjeteruar dhe kërkon azhornim
- GVJ konstoi raste te syllabuseve qe nuk janë ne përputhje me emërtesën e lendes ne programin e se cilës përmbajtja dhe literatura mbulojnë vetëm pjesërisht lenden.

**Per sa me sipër GVJ konkludon se standartet që lidhen me "Programin e studimit dhe organizimin e tij", konsiderohen të përmbushura kryesisht**

Rekomandime:

- *Nga vizita në institucion e GVJ dhe nga analiza qe u eshte bere syllabuseve te lendeve, sugjerohet rishikim thelbesor i syllabuseve, temave dhe literatures, ne menyre qe studentet qe perfundojne kete program te jene me konkurrues ne tregun e punes si dhe per përgatitjen e tyre për ciklin e tretë të studimeve*
- *GVJ sugjeron vendosjen e nje diapazoni me te gjere ne format e vleresimit te parashikuara ne syllabus, per te lejuar nje fleksibilitet me të lartë ne format e vleresimit, kjo ne perputhshmeri me natyren e lendeve;*

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

***Terma reference:*** *organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhenies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

GVJ gjate shyqrtimit te informacinit te depozituar nga AU si dhe nga takimi qe pati me stafin akademik te programit, konstatoi se metodat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", janë të shumëllojshme. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një drejtimore (nga pedagogu tek studentët), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Disa nga metodat e mësimdhënies që janë përdorur në lëndë të ndryshme, në varësi edhe të natyrës dhe objektivave të formimit janë: Punë në grup, Prezantimet të rasteve studimore, organizimi i leksioneve me figura të njohura të fushës, *[Evidence 35.2 Aktivitete - Departamenti i Shkencave Ekonomike 2017 - 2018.pdf, vizita ne institucion]* etj.

Lëndët e programit të studimit në "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", organizohen në 6 kategori disiplinash:

- Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë — 12 ECTS
- Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit — 43 ECTS
- Kategoria C: Disiplina me zgjedhura — 12 ECTS
- Kategoria D: Disiplina formuese te zgjedhura/kurse te lira — 11 ECTS
- Kategoria E: Veprimtari formuese — 6 ECTS
- Kategoria F: Punimi i Diplomës — 36 ECTS

Në Tabelën 11 në anekse jepen edhe të gjithë modulet përkatëse për secilën kategori të përshkruar me sipër.

Lidhur me peshën që zënë secila prej këtyre kategorive në totalin e përgjithshëm të krediteve ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për kohën kur është bërë analiza e programit (Udhezim nr. 15, dt. 4.4.2008). Konkretisht, modulet e kategorisë A (12 ECTS) përbëjnë 10% të totalit të përgjithshëm të kreditëve të programit. Ndërkohë që modulet e kategorisë B përbëjnë 36% të krediteve të

përgjithshme, kategoria C përbën 10%, kategoria D 9%, kategoria E 5% dhe kategoria F 30%. Pesha që zë secila kategori është në përputhje me udhëzimet e Ministrisë.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet: [Tabela 14, shtojca bashkëlidhur]

- Leksione 450 orë
- Seminare 405 orë
- Laboratore NA
- Praktikë lëndore NA
- Praktikë profesionale N/A
- Diploma 120 orë

Ndërkohë ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies Leksione, Seminare, dhe punim diplome, është 975 ore. *[Tabela 14, shtojca bashkëlidhur]*

☑ Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve të studentit realizohen me anë të disa elementëve; ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10%, plotësimi i detyrimeve 10%, testimet gjatë vitit 20% dhe testi përfundimtar 60%. Në detaje këta elementë dhe pesha që ata zënë ndaj totalit të vlerësimit të përgjithshëm jepen në Tabelën 15, në Anekse.

☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 16 ne Anekse)

GVJ nga vizita në institucion konstatoi raste kur studentët kane marre pjese ne konferencën studentore te organizuar nga AMF. *[Evidence 32. Konferenca e AMF.pdf]* Nga pjesëmarrja ne kete konference disa prej studenteve kane qene fitues te çmimeve te dhëna. Nga informacioni i siguruar gjate vizitës ne institucion, u konstatuan pjesëmarrje e e studenteve ne organizime te aktiviteteve te ndryshme, si leksione te hapura, tryeza te rrumbullakta, seminare informuese etj.

## 9. Studentët

**Pjesa përshkrimore**

> ***Terma reference**: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

GVJ nga takimet me studentët, stafin akademik, stafin mbështetës dhe drejtues, konstatoi se, institucioni ne procedurat e pranimit ne Programin e Studimit Master i Shkencave ne Admnistrim Biznesi, respekton kërkesat qe burojnë nga aktet ligjore dhe nenligjore, dhe se AU nuk vendos kritere te tjera shtese per pranimin e studenteve ne kete PS.

Ne lidhje me numrin e studenteve te rregjistruar GVJ, konstatoi se numri i rregjistrimeve eshte ai qe eshte deklaruar ne RVB dhe konkretisht:

- Në vitin akademik 2012 – 2013 u regjistruan 38 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.58, dhe 1 student i transferuar që ka ardhur në vitet e ndërmjetme

- Në vitin akademik 2013 – 2014 u regjistruan 13 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.48; u diplomuan 20 studentë.
- Në vitin akademik 2014 – 2015 nuk pati studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë; u diplomuan 15 studentë.
- Në vitin akademik 2015 – 2016 u regjistruan 32 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 5.8; u diplomuan 4 studentë.
- Në vitin akademik 2016 – 2017 u regjistruan 10 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 6.34 dhe 4 studentë të transferuar në vitin e dytë; u diplomuan 14 studentë.
- Në vitin akademik 2017 – 2018 u regjistruan 14 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 5.9, dhe 2 studentë të transferuar në vitin e dytë; u diplomuan 6 studentë.

Numri i studentëve të regjistruar në programin "Master i Shkencave" në Administrim Biznesi, ka patur renie në vitet e fundit. IAL e argumenton këtë rënie të numrit të të rregjistruarve me vendosjen e kriterit te mbrojtjes se gjuhës angleze.

Mesatarja e studenteve te rregjistruar ne kete program eshte 5.8-6.58, ne vitet e fundit kjo mesatare ka ardhur duke u ulur.

AU ka një procedurë të qartë të transferimit të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Procedura e transferimit bazohet në Udhezimet që nxjerr MASR në vitin akademik përkatës, dhe në Statutin dhe rregulloren e AU

Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban të dhëna për punësimin e studentëve dhe ruan marrëdhëniet me ta edhe pas mbarimit të programit të studimit, ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Referuar rregullores se programit master si dhe RVB, GVJ konstaton se për të ndjekur programin e studimit MSc në "Administrim Biznesi" çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo ekuivalente
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë
3. Të plotësojë kriteret e përcaktuara nga udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Ne lidhje me kriteret akademike te pikës 2, GVJ nuk identifikoi kritere specifike përveç atyre te parashikuara nga pika 3.

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

GVJ konstaton se cilësia e studentëve në hyrje nuk kontrollohet nga kufiri i mesatares si kusht regjistrimi. Kështu nëse shohim të dhënat e viteve të fundit ka studentë që kanë hyrë në ciklin e dytë të studimeve me mesatare 5.8-6.58. *[Tabela 17 në Anekse].*

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Statistika e RVB lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në vitin e Parë dhe transferimet, si dhe te verifikuara gjate vizitës ne institucion perputhen. Keto te dhëna jepen ne jepen në Tabelën 17 në Anekse.

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve

Lidhur me punësimin e studentëve, AU disponon të dhëna dhe statistika të rregullta prej 6 vitesh. Këto statistika në mënyrë të përmbledhur jepan në Tabelën 18 në Anekse.

Vihet re që në 6 vitet e fundit për të cilët janë marë këto statistika, jane 109 te diplomuar, nga te cilet përqindja e të punësuarve sipas profilit të diplomës së tyre eshte 55%, ndersa 15 % jane të punësuar jashte profilit. Për pjesën tjeter te te diplomuarve nuk jepen te dhena per statusin e tyre ne tregun e punes.

☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Statistika e mara nga IAL lidhur me numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën dhe jo me diplomën, jepen në Tabelën 18 në Anekse. Vihet re se numri i të diplomuarve në përputhje me diplomën është disa herë më i lartë se ai jo në përputhje me diplomën.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;<br>**Kriteri 2** Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 3** Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;<br>**Kriteri 4** Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;<br>**Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit. | GVJ konstaton nga rregullorja e programit dhe nga kontrolli ne menyre rastesore i dosjeve te studenteve, se kriteri kryesor per studentet qe rregjistrohen ne kete program studimi eshte që të zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS<br>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi", pranë AU, kryhet sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.<br>GVJ nuk konstatoi kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, sic mund të ishte nota mesatare ne hyrje<br>Sipas kritereve të fundit ligjore, studentet që të mund të regjistrohen në "Master Shkencor" duhet ta kenë paraprakisht diplomën e Anglishtes sipas nivelit të kërkuar. AU që vitin e kaluar e ka zbatuar me korektësi këtë kriter. Sipas drejtuesve te institucionit ky kriter ka impaktuar negativisht numrin e studentëve te rregjistruar |
| **Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.** | |
| **Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;<br>**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. | Nga takimet me perfaqesues te zyres se karierres, rezulton se studenteve ne javen e pare te vitit akademik ju jepet informacion i nevojshëm në lidhje me programin e studimit, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve, akreditimin e programit ku ata aplikojnë, etj.<br>Në strukturen e AU jane dy zyra që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit.<br>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve qe mbështet studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit si dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit siguron lidhjet për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe tregun e punës. *[Evidence, 37. Studente te rekomanduar nga zyra e* |

| | |
|---|---|
| | *karrieres dhe alumni.pdf; Evidence,35.1 Kalendari_i Aktiviteteve_Zyra_e_Karrieres(1).PDF, Vizita ne institucion]* |

**Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;<br><br>**Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. | GVJ konstaton se AU disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programin e studimit Msc. ne Administrim Biznesi. Këto të dhëna raportohen çdo vit pranë Drejtorisë së statistikave në MAS. Ndërkohë të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin përkatës dhe qe u kontrolluan gjate vizitës ne institucion<br><br>AU mban statistika vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e ciklit të dytë të studimit. GVJ ju vendosen ne dispozicion statistika rreth studenteve te regjistruar në vite dhe ecurisë së tyre. [Tabela 17 në Anekse].<br><br>Gjate vizitës ne sekretarinë e AU, në rregjistrat u identifikuan disa raste te studenteve pa numër matrikullimi. Vonesa e pajisjes me numër matrikullimi ka ardhur per shak te procedurave verifikuese, dhe per kete institucioni vendosi ne dispozicion te GVJ korrespendoncen me MASR, qe argumenton kete vonese *[Evidence 27.2 Shkrese nga QSHA (per matrikullimin e studentetve).pdf, Vizita ne institucion]*<br><br>GVJ konstatoi se AU disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit studimor që nga pranimi deri në prag të diplomimit, dokumentacion ky qe u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Keto te dhëna u siguruan ne dokumenta te tille si regjistri i themeltar, regjistri i notave, regjistri i diplomave si dhe rregjistri i cdo lende. GVJ gjate vizitës ne sekretarinë mesimore, konstatoi se ne rregjistrin e lendeve kishte mangësi ne plotësimin e mungesave, ku vihej re qe gjate pjesës me te madhe te semestrit nuk kishte mungesa te identifikuara |

**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj. | GVJ konstaton se AU disponon një bazë të dhënash për punësimin e studentëve pas përfundimit të programit. [Tabela 18 në Anekse]<br><br>70 % e studentëve që ndjekin studimet janë të punësuar, ku 55% jane te punesuar ne perputhje me diplomen. |

**Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;<br><br>**Kriteri 2** Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit | Gjatë vizitë në institucion, GVJ konstaton se që në momentin e interesimit dhe më pas të regjistrimit dhe në vijimësi studentët informohen për programin e studimit. Informacioni i nevojshëm ndodhet në faqen e internetit të universitetit, ofrohet nga |

| | |
|---|---|
| gjatë dhe në përfundim të programit;<br>**Kriteri 3** Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. | personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ si dhe nga pedagoget e lendeve ne javën e pare te cdo semstri<br>Nga takimi me stafin akademik, rezulton se në fillim të cdo moduli, studentët njihen me strukturën e tij si dhe me mënyrat e vlerësimit.<br>Pas cdo provimi, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer dhe trajtim te ankimimeve qe studentet mund te kenë. |
| **Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;<br>**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. | AU u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor, duke organizuar seanca konsultimesh me studentet ne displina te caktuara, apo seanca te hapura te ballafaqimit student-pedagog per ankimet qe studentet mund te kene per vleresimin.<br>PS Msc. ne administrim Biznesi, nuk ka ne kurrikule praktike. |

**<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>**

- GVJ nga vizita ne institucion konstatoi se, studentët informohen për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve.
- AU disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë
- Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës si dhe ofrohen sherbime te tjera mbeshtetese nepermjet Zyres se Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve
- GVJ gjate vizitës ne sekretarinë mesimore, konstatoi se ne rregjistrin e lëndëve kishte mangësi ne plotësimin e mungesave, ku vihej re se në lëndë te caktuara, gjate pjesës më të madhe te semestrit nuk kishte mungesa te identifikuara.

**Për sa me sipër GVJ konkludon se standardet përmbushen kryesisht**

<u>Rekomandime:</u>

- *GVJ referuar edhe pjesëmarrjes se ulet te studenteve gjate takimit te organizuar me ta, sugjeron qe institucioni te ketë nje qasje me proaktive ne lidhje me orientimin dhe informimin e studenteve me të drejtat dhe detyrimet e tyre qe burojnë nga rregullorja e AU, rregullorja e programit, me penalitetet ne rast mosfrekuentimi dhe t'i motivojë ata për te qenë pjese me aktive e proceseve mesimore, kërkimit shkencor si dhe aktiviteteve te tjera qe AU organizon.*
- *GVJ sugjeron vendosjen e një kufiri minimal për mesataren e pranimit ne Msc ne Administrim Biznesi, me qëllim orientimin drejt rregjistrimit të studenteve me cilesor ne hyrje*

## <u>KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT</u>

## 10. Kërkimi shkencor

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Politika e Departamentit të Shkencave Ekonomike në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor është nje politike ne funksion të implementimit te strategjise se AU per kerkimin shkencor. Nga struktura e AU, konstatohet se për kërkimin shkencor ne nivele drejtuese te institucionit, eshte Zv/Rektorin për Kërkimin Shkencor, i cili synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor. Strategjia per kerkimin shkencor eshte miratuar nga senati akdemik

Në mbeshtetje te rritjes se produktit te kerkimit shkencor ne AU eshte edhe Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike si dhe Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet. GVJ nga vizita ne institucion konstaton se AU botot nje periodik qe është revista "OPTIME", me ISBN dhe me bord editorial, qe ka botime ne disa fusha ku jane te perqendruara programet e studimit te AU, mes tyre dhe botime ne fushen e ekonomise. Kjo reviste konstatohet nga takimet me drejtues dhe me stafin akademik te programit, se ka mbeshtetur inciativat per botime te stafit akademik, botime të cilat kanë plotësuar kriteret qe revista ka. GVJ nuk konstatoi nje norme mesatare te pranimit/refuzimit te artikujve ne kete reviste.

Ashtu sic paraqitet edhe ne RV, por edhe nga informacioni i marre gjate vizitave ne AU, përfshirja e pedagogëve në projekte të kërkimit shkencor por edhe ne botime ne revista akademike, ka qenë kryesisht mbi bazen e prioriteteve individuale në kuadër të projekteve të tyre të doktoraturës ose per marrjen e titujve akademike

GVJ vlereson inciativen e pervitshme te Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike, per organizimin e Konferencës *[Evidence, 10.2.Thirrja e Konferences Nderkombetare.pdf; Dosja e vetevleresimit]* në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universitetin La Sapienza, Romë si dhe dhe Konferencën Studentore me temë "Zhvillimi i qëndrueshëm" *[Evidencë 10.3.Thirrja e Konferences Studentore.pdf, Dosja e vetevleresimit]*.

Persa i perket projekteve sugjerohet nje perfshirje me e madhe e stafit te njesise baze ne projekte kombetare apo nderkombetare. Deri tani sic raportohet nga RVB si dhe nga takimet me drejtues te njesise kryesore dhe baze, njesia baze ka aplikuar ne 4 projekte, dhe eshte fituese e një Erasmus+ me Kolegjin Powislanski në Poloni, nga e cila ka përfituar mobilitet 1 student nga AU dhe 4 pedagogë nga Kolegji Powislanski. Vleresohet pjesemarrja e AU ne projektin "GRADUA", ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë. GVJ sugjeron qe institucioni duhet te siguroje mekanizmat qe do te nxisin pjesemarrjen e stafit akademik dhe studenteve te progamit master i Shkencave ne Administrim Biznesi ne projekte te ndryshme shkencore, si dhe ne botime shkencore ne revista prestigjoze nderkombetare me faktor impakti

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat 19 dhe 20 ne aneks)

Te dhenat per kerkimin shkencor, projekte kerkimore, konferenca shkencore dhe botime sheknCore brenda dhe ashte vendit, paraqiten ne tabelën 19 dhe 20 bashkelidhur kesaj shtojce.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e | GVJ konstaton se personeli akademik efektiv, konstatohet se janë aktiv në punën kërkimore shkencore përmes pjesëmarrjes ne konferenca dhe ne botime ne revista. Një fakt i tillë rezulton dhe nga statistikat, të cilat mbahen periodikisht, por dhe nga të dhënat |

| | |
|---|---|
| sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. | e përgjithshme që disponon njësia baze, apo raportimet individuale të secilit pedagog. *[Evidence CV e stafit; Tabela 19; Tabela 20, Evidence 10.7.Model Formulari i Kerkimit Shkencor i Pedagogut.pdf]* |
| **Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.** | |
| **Kriteri** 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri. | GVJ gjate vizitës ne institucion dhe nga takimet me stafin e programit nuk konstatoi mësimdhënie ne gjuhe te huaj |
| **Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri** 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;<br>**Kriteri 2** Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. | GVJ nga konsultimi i informacionit nëpërmjet sistemit AMS, konstaton se AU organizon trajnime për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor *[Evidence 6.4.Trajnime Stafi te Brendshme.pdf, Dosja e vetevleresimit]*<br>Nga informacioni I siguruar nga dosja e vetevleresimit por edhe nga takimet me drejtues dhe stafin akademik te programit, GVJ konstaton se AU i krijon stafit akademik, mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit, duke ju akorduar lejen e paguar ne te tilla raste dhe pjesemarrjen me tarife te reduktuar ne aktivitetet shkencore qe zhvillon AU *[Evidence, 10.8.Financimet e Universitetit per Pedagoget.pdf, Dosja e vetevleresimit]*<br>GVJ konstaton nga informacioni i vendosur ne dispozicion nga institucioni, se mbështetja financiare nga institucioni ka ekzistuar, por konsiderohet ne nivele relativisht te ulta. Per sa me sipër GVJ sugjeron intensifikimin e mbështetjes financiare ndaj stafit akademik per pjesëmarrjen e tyre ne aktivitete shkencore dhe trajnime si dhe vendosjen e nje sistemi pikëzimi dhe bonusesh per stafin akademik, per te matur kontributin e tyre por edhe per ti motivuar ata. |
| **Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.** | |
| **Kriteri** 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;<br>**Kriteri 3** Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. | GVJ konstaton se AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë edhe personeli akademik i angazhuar në programet e studimit Master i Shkencave ne Administrim Biznesi, te dhëna këto qe sigurohen nga vetedeklarimi i stafit akademik sipas formularit per kërkimin shkencor *[Tabela 19, Tabela 20, shtojca bashkëlidhur, Evidence 10.7.Model Formulari i Kerkimit Shkencor i Pedagogut.pdf, Dosja e vetevleresimit]* GVJ konstaton se këto te dhëna janë ne nivel institucional.<br>Nga informacioni i siguruar GVJ nga RVB si dhe nga takimet me |

| | |
|---|---|
| | drejtuesen e njësisë baze, konstaton se pedagogët e kësaj njësie kane aplikuar ne 4 projekte kërkimore-shkencore, nderkohe qe janë pjese edhe projektit Gradua qe eshte duke u implementuar. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Stafi akademik efektiv është i përfshirë në proceset e kërkimit shkencor
- AU ka paraqitur një listë të projekteve ku institucioni ka aplikuar dhe është përfshire megjithate në pasqyrat financiare nuk përfshihet si zë të ardhurat nga projektet.
- AU, referuar CV te stafit, disponon informacion në lidhje me punën shkencore të çdo anëtari të departamentit.
- AU boton periodikun "Optime" dhe FSHA organizon ne menyre te përvitshme konferenca shkencore, duke rritur mbeshtjen per prezantimin dhe botimin e punimeve te stafit akademik dhe te studentëve në nivelin master, që plotësojnë kriteret e botimeve te te tilla niveleve

**Nga sa më sipër për Kërkimin shkencor, standardet përmbushen kryesisht**

Rekomandime:

- *GVJ sugjeron intensifikimin e mbështetjes financiare per te nxitur pjesemarrjen e stafit akademik dhe studenteve te progamit master i Shkencave ne Administrim Biznesi, ne botime shkencore ne revista prestigjoze nderkombetare me faktor impakti*
- *GVJ sugjeron qe institucioni te siguroje mekanizmat qe do te nxisin pjesemarrjen ndaj stafit akademik ne aktivitete shkencore dhe trajnime, si dhe vendosjen e nje sistemi pikëzimi dhe bonusesh per stafin akademik, per te matur kontributin e tyre por edhe per ti motivuar ata.*

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

**Pjesa përshkrimore**

> ***Terma reference**: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

GVJ nga shqyrtimi i informacionit te depozituar ne sistemin AMS, konstaton se AU dhe FSHAE ka 7 marrëveshje bashkëpunimi më Universitete të huaja dhe shqiptare, si universiteti i Tiranes, Universiteti i Durresit "Aleksander Moisiu", Kolegji Powislanski, Poloni, Universiteti "Angel Kanchev" Ruse [Tabela 21]. Keto bashkepunime jane ne fusha te shkembimit te stafit akademik per mesimdhenie, krysisht mes AU dhe universiteteve shqiptare, si dhe bashkepunime ne pjesemarrje ne projekte te perbashketa dhe ne organizimin te ndersjelle te aktiviteteve shkencore. *[Evidence, 11.1.Marreveshje bashkepunimi me Universitete.pdf,* Evidence 28.2 Mareveshje bashkepunimi me Univ. Tiranes.pdf, *Vizita ne institucion]*

